



**Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6)
Aplikacioni për Tarifa**

16 janar 2012

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-CLRR-032
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 5</i>

1. Hyrje

Me datë 10 janar 2012, KOSTT ka pranuar nga ZRrE njoftimin lidhur me planin e realizimit të shqyrtimit të gjashtë të tarifave të energjisë elektrike(SHTE6) që ka të bëjë me të Hyrat e Lejuara si dhe tarifrat dhe ngarkesat e reja që do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data 1 prill 2012.

Me këtë dokument dhe dokumentet tjera përcjellëse KOSTT paraqet në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Aplikacionin për të Hyrat e Lejuara për operatorin e sistemit, transmisionit dhe tregut për vitin 2012.

Kërkesa për Të Hyrat e Lejuara për vitin 2012 në vlerë prej € 20,931,000.00 është me e madhe se sa të Hyrat e lejuara për vitin 2011 pasi që në këtë aplikacion janë trajtuar edhe asetet e para vitit 2006 dhe asetet të cilat do të transferohen nga KEK në KOSTT sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.10/29 i datës 03.08.2011.

Kërkesa për Të Hyrat e Lejuara për vitin 2012, për asetet para vitit 2006, është bërë me vlerë të aseteve sipas dokumentit për rivlerësim të aseteve dërguar nga KOSTT në ZRRE-së me dt. 24.08.2010 si dhe ne baze të komenteve të KOSTT në dokumentin e ZRrE të lëshuar për konsultim publik në gusht të vitit 2011 **Rivlerësimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve – Raport Konsultativ.**

Pasi që koha e përcaktuar nga ZRrE ka qenë e shkurtër, kjo medoemos mund të reflektojë në kualitetin e aplikacionit e posaçërisht nga fakti se KOSTT dhe KEK janë në proces të implementimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferim të aseteve.

2. Trajtimi i Aseteve të KOSTT

Edhe në SHTE5 KOSTT ka bërë të ditur vizionin e vet për zgjidhjen e qasjes për trajtimin e aseteve të para 2006. Paraprakisht KOSTT ka propozuar që vlera e aseteve të para 2006 të kthehet në nivelin që ka qenë para shlyerjes së bërë me 31 dhjetor 2004, 115 mil€. Në këtë aplikacion kjo vlerë është paraqitur e zbritur për vlerën e amortizimit 2005-2011. KOSTT është i vetëdijshëm se deri më tani nuk është paraqitur ndonjë obligim kreditor për këto asete prandaj edhe kërkon që trajtimi i tyre të bëhet vetëm në RAB e jo edhe në RABf që d.m.th. për këtë vlerë kërkon vetëm mbulimin e shpenzimeve të amortizimit.

Vlera totale e aseteve e paraqitur në RAB fillestarë të vitit 2012 është **€171,073,074.00**

dhe përfshinë:

- gjendjen bruto fillestare të RAB në vitin 2011	€58,888,146.00
- asetet e KOSTT të para 2006	€85,605,388.00
- asetet KEK 110 kV para 2006	€8,165,990.00
- asetet KEK 110 kV pas 2006	€7,042,600.00
- KOSTT – investimet 2011	€11,370,950.00

3. Shpenzimet operative

Mirëmbajtja është e një rëndësie të jashtëzakonshme në përmirësimin e besueshmërisë dhe kapacitetit të sistemit elektroenergetik të Kosovës, si dhe është vendimtare që të lejohen të hyra të mjaftueshme për të zgjeruar programin e mirëmbajtjes.

Duke pas parasysh këtë rendësi, KOSTT brenda strukturave të veta ka shërbimet e mirëmbajtjes së rrjetit transmetues për linjat dhe nënstacionet. Kjo na obligon që varësisht nga nevojat të bëjmë edhe furnizimin me pjesë rezerve adekuate apo pajisje pune të cilat ndikojnë në rritjen e efijencës së shërbimeve.

Nga ana tjetër, menaxhimi i aseteve përkatësisht përcjellja e jetës dhe parametrave të tyre si dhe krijimit të kushteve të sigurisë për punë të aseteve dhe rreth nës na obligojnë zbatimin e rregulloreve dhe standardeve relevante. Përmbushja e tyre gjithëherë nuk mund të mbulohet nga shërbimet brenda KOSTT-it me çka kërkohet angazhim i shërbimeve nga jashtë.

Bazuar në gjendjen e aseteve të transmisionit, rritjes së konsumit, nevojës për efikasitet dhe efijencë më të madhe, implementimin e mirëmbajtjes preventive etj nevojat për buxhet të mirëmbajtjes janë të vazhdueshme.

Me datë 3 gusht 2011 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë Vendim për kalimin e aseteve 400/220/110 kV dhe transformatorëve 220/35/10(20) dhe 110 kV, si dhe të fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV me ç'rast asetet do të kalojnë nga KEK në KOSTT. Është formuar Grupi Punues i cili do të përgatit Marrëveshjen për implementim të Vendimit si dhe dokumentet përcjellëse për transferim të aseteve nga KEK në KOSTT. Implementimi i vendimit reflektohet në vlerën e aseteve dhe koston e operimit të Sistemit të Transmisionit. Kjo do të jetë një baze e duhur për të përcaktuar parametrat ekonomik për planifikimin e mirëmbajtjes në rrethana të reja si dhe çështje për diskutim varësisht nga pikëpamjet e përcaktuara nga ZRrE.

Rritja e vlerës së aseteve dhe numrit të punëtorëve ndikon dukshëm në rritjen e shpenzimeve operative për të gjitha kategoritë.

Në kuadër të shpenzimeve operative, qasja e KOSTT ndaj shpenzimeve të mirëmbajtjes në vazhdimësi ka qenë në pajtim me Metodologjinë së Tarifave të Sektorit të Energjisë Elektrike. Zakonisht 20% deri 30% e buxhetit të mirëmbajtjes është shpenzuar për mirëmbajtje të aseteve, kurse pjesa tjetër është shpenzuar për ripërtëritjen e infrastrukturës, ashtu siç e ka përcaktuar metodologjia tarifore. Qasja në këtë aplikacion ndryshon meqenëse kërkohen të hyra për mirëmbajtje duke mos konsideruar ripërtëritjen e infrastrukturës.

Të hyrat që kërkohen për mirëmbajtje në vitin 2012 i afrohen standardeve të sistemeve të transmisionit në rajon. Me këtë bëhet eliminimi i shfrytëzimit të buxhetit të mirëmbajtjes për rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe ngritja e gatishmërisë dhe kapaciteteve me investime kapitale. Buxheti i kërkuar për mirëmbajtje për vitin 2012 do të ndryshojë për shkak se pritet rritja e kërkesës për shpenzime të mirëmbajtjes duke u bazuar në rritjen e vlerës së aseteve për të cilat ende nuk kemi të dhëna të sakta për gjendjen dhe jetëgjatësinë e aseteve që do të transferohen.



Qasja e ndryshuar për kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtje ndryshon në terma afatgjatë dhe siguron një zhvillim të tarifave të transmisionit me lëvizje të ngadalësuara.

Në terma relative kostoja e mirëmbajtjes në këtë aplikacion është nën standardet që kërkohen për këtë aktivitet. Kjo është si rrjedhim i investimeve intensive në periudhën e kaluar si dhe atyre që planifikohen në të ardhmen.

4. Shërbimet Ndhmëse

Kërkesa për të hyra për Shërbimet Ndhmëse mbetet e nivelit të njëjtë si në vitin paraprak meqenëse projekti i Rregullimit Frekuencë – Fuqi do të financohet nga KfW ku parashihet edhe vendosja e një regjimi të operimit me Shqipërinë gjë që pritet të realizohet deri fund të vitit. Aranzhimet komerciale të këtyre shërbimeve gjithashtu do të jenë subjekt të këtij projekti që pritet të realizohet gjatë vitit 2012. në mungesë të parametrave më të saktë të një kontrate tregtare jemi të prirë që kërkesa të mbetet e njëjtë si për vitin 2011.

5. Humbjet në Transmision

Sipas shqyrtimit SHTE5 për vitin 2011, përqindja e humbjeve në transmision ka qenë 2.3 %, ndërsa energjia e parashikuar në disponim ishte 5675.2 GWh. Si rezultat volumi i humbjeve të lejuara është paraqitur 130.5 GWh.

Energjia e matur në vitin 2011 tregon rrjedha më të mëdha se sa ato të parashikuara, respektivisht energjia në disponim gjatë vitit 2011 ka qenë 5938.4 GWh, çka rezulton në rritjen e volumit të humbjeve të lejuara në 136.6 GWh. Humbjet e matura në transmision gjatë vitit 2011 janë 116 GWh. Siç po shihet, KOSTT me një efikasitet të ngritur ka arritur t'i zvogëlojë humbjet në transmision kundrejt atyre të lejuara për 20.6 GWh. Në Të Hyrat e Lejuara 2011 KOSTT-it i janë përfshirë të hyra në emër të humbjeve në transmision për 130.5 GWh, kurse me rrjedhat e realizura të energjisë humbjet e lejuara për KOSTT llogaritet 136.6 GWh. Në Të Hyrat e Lejuara 2012 për KOSTT mbetet të përfshihen edhe të hyrat për diferencën e mbetur prej 6.1 GWh. Sipas Metodologjise së Tarifave në bazë të së cilës janë kalkuluar të hyrat dhe tarifat e vitit 2011 KOSTT mbanë diferencën në mes të humbjeve të lejuara dhe të realizura si formë stimuluese për zvogëlim të mëtutjeshëm të humbjeve.

Kërkesa e KOSTT për humbjet në transmision të vitit 2012 është e bazuar në Rregullën për Çmime të OST/OT-së. Volumi i kërkuar është 136 GWh. Kjo vlerë paraqet humbjet aktuale të vitit 2011 plus 20 GWh – humbje që pritet të realizohen në transformatorët 110/10 kV, 110/35kV, 220/35/10 kV që transferohen në KOSTT.

KOSTT për vitin 2012 propozon që faktori i ndarjes për humbjet në transmision të jetë 50 – 50.

6. Shpenzimet Kapitale

Për vitin 2012, KOSTT planifikon të realizojë projekte kapitale në vlerë 30,058,974.00 €. Buxheti i donacioneve për këtë vit planifikohet të jetë €17,248,194.00; kredi €2,843,250.00, ndërsa financimi nga KOSTT € 9,967,530.00.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-CLRR-032
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 5</i>

Një ndikim të dukshëm në vlerë totale të investimeve të parashikuara për vitin 2012 paraqesin pozicionet e projekteve Ferizaji 2 dhe Prizreni 2 të cilat pothuajse janë përfunduar dhe do të hyjnë në funksion gjate këtij viti, vlera e të cilave sillet rreth 13 mil. Euro.

Dokument i veçantë është edhe Plani Investiv për KOSTT për vitin 2012.

(FUND I DOKUMENTIT)